VENDIM
Nr. 237, datë 26.11.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBANIAN ENERGY SUPPLIER 2" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", si dhe nenit 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 144/3 prot, datë 17.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Albanian Energy Supplier 2' sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Albanian Energy Supplier 2" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1076 prot., datë 11.11.2021, ka paraqitur aplikimin për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "Albanian Energy Supplier 2" sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat "a", "b", plotësuar.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "e", plotësuar.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat "a", "c", "d", plotësuar.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika "a", "c", plotësuar.
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germa "c" (të dhëna për aplikuesin);
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa "d" (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata);
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa "b" (bilanci financiar i tre viteve të fundit /ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë, shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit).
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, germa "b" (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj); germa "e" (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo

marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi); germa "g" (dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'u ofrohen klientëve); germa "i" (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët).

Subjekti do të njoftohet që në bazë të neneve 10, pikat 10 dhe 11, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", ta paraqesë atë brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Albanian Energy Supplier 2" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti